



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Primijsno/Prodato Received/Delivery	05-04-2023	3	viti god. Year
Organ/Njësia Organ/Unit	Nr Prot Pr No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/BHCK	3314/2023		113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.414/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.414/2023 të datës 24.02.2023, të parashtruar nga ankuesi _____, nga Prishtina, kundër organit të punësimit Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 05.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.414/2023 e datës 24.02.2023, e parashtruar nga ankuesi _____
- II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.Ref 61/2023 i datës 10.02.2023, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Nëpunësi _____ i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 24.02.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.Ref.61/2023 të datës 10.02.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me pretendimin që vendimi i kundërshtuar nuk është i drejtë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa, Këshilli me datë 06.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2047/2023 të datës 24.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër ref.61/2023 të datës 10.02.2023; Emalin e datës 14.02.2023 të ankuesit drejtuar _____; Emalin e datës 08.02.2023 të _____ drejtuar _____; Emalin e datës 26.09.2022 të _____ drejtuar _____; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 2187/2023 të datës 28.02.2023; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 2373/2023 të datës 06.03.2023; Akt emërimit me numër të protokollit 2152 të datës 13.06.2022; Listën e pagave për muajin janar dhe shkurt 2023; përshkrimin e detyrave të punës të datës 04.06.2014 për ankuesin.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të pabazuar pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji ka konstatuar së Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 26.09.2022 ka njoftuar ankuesin së të njëjtit më datë 03.03.2023 i përfundon marrëdhënia e punës për shkak arritjes së moshës së pensionimit dhe së bazuar në nenin 22 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil i takon e drejta e kompensimit të një page në shumën prej një page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit. Ndërsa me datë 08.02.2023 Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka njoftuar ankuesin së më hyrjen në fuqi të Rregullores 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, kompensimi i një page me rastin e pensionimit nuk ju takon, kurse më datë 10.02.2023 Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka marrë Vendimin me Nr.Ref.61/2023 për përfundimin e marrëdhënies se punës se ankuesit me datë 03.03.2023 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

Ankuesi brenda afatit ligjor parashtron ankesë kundër Vendimit Nr.Ref.61/2023 të datës 10.02.2023 të Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme, me pretendimin ankimor se njoftimet e Njesisë së Burimeve Njerëzore janë kundërthënëse njëra me tjetrit dhe së një veprim i tillë përben padrejtësi për ankuesin. Kërkon që Këshilli t'i njeh të drejtën e kompensimit të një page shtesë me vlerën e pagës së fundit me rastin e pensionimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, dhe si rrjedhojë bazuar në vlerësimin e shkresave të lëndës ka konstatuar së Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike lidhur me këtë çështje administrative, dhe ka aplikuar drejtë dispozita materiale, sepse në kohën e dërgimit të njoftimit të datës 26.09.2022 ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, ku me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të të njëjti ligj është paraparë pagesa për shkak të pensionimit, e rregulluar në mënyrë specifike më Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, me c' rast me nenin 19 të kësaj rregullore është përcaktuar se: *Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin*

Civil, gëzon të drejtën e kompensimit. 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit”.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023 dhe si rrjedhojë me nenin 45 paragrafi 1 dhe 2 është përcaktuar se: 1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil; 2. Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t’u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji. Andaj, me krijimin e këtyre rrethanave të reja ligjore, Njësia e Burimeve Njerëzore ka vepruar drejtë me rastin e nxjerrjes së Vendimit të kundërshtuar me ankesë përkatësisht Vendimit Nr. Ref.61/2023 i datës 10.02.2023, sepse Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk parasheh ndonjë lloj pagese apo kompensimi me rastin e përfundimit të marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit të nëpunësit civil, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të bazuara ligjërisht.


Theksuar si me lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: vendimi hyn në fuqi ditën e anëshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.414/2023

Ilire MEHMETI-SHAQIRI



Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit ;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- Arkivit të KPMSHCK-së